



Prishtinë, 15.04.2009
Kodi i ZRRE-së: V_172_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 dhe Nenit 47, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e “Rregullës mbi Parimet e llogaritjes së tarifave në sektorin e energjisë elektrike (Rregulla e Çmimeve)”;
3. Dispozitat e “Metodologjisë së tarifave për sektorin e energjisë elektrike”;
4. Kërkesën e KOSTT-SH.A për Shqyrtimin e tarifave të transmisionit të datës 18 shkurt 2009
Në seancën e mbajtur me datë 15 prill 2009 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** Tarifat dhe ngarkesat e transmisionit, që do të zbatohen nga KOSTT-SH.A. nga data 1 prill 2009.
1. Vendimi bazohet në dokumentet e lëshuara dhe të publikuara nga ZRRE-ja në faqen elektronike zyrtare të saj si:
 - Shqyrtimi i Tretë i Tarifave të Energjisë Elektrike 2009 – Raport Konsultativ dhe Raporti Konsultativ shtesa për KOSTT, lëshuar më 03 mars 2009 dhe 05 mars 2009;dhe
 - Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike 2009 – Përgjigje ndaj Komenteve në Raportin Konsultativ lëshuar më 02 prill 2009.
2. Struktura e tarifave dhe ngarkesave të cilat do të zbatohen nga KOSTT SH.A data 01 prill 2009 është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela: Tarifat dhe Ngarkesat për KOSTT-SH.A që do të zbatohen nga data 1 prill 2009

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Aprovuar
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.328
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.636
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	10.094
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020

- Ky Vendim duhet të publikohet nga KOSTT Sh.A brenda 5 ditëve të punës pas njoftimit të ZRRE-së dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të saj, së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
- Ky Vendim lëshohet në gjuhën shqipe dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast mospërputhjes midis përkthimeve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së tij, kur edhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditësh nga data e hyrjes së vendimit në fuqi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar